



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odeljenje za Opštu Upravu
Nr. I prot. 3968
Br. prot. 31.12.2024
Më 31.12.2024
Dt. 31.12.2024
RAHOVEC - ORAHOVAC



Datë/e	25.11.2024
Referencë/e	
Për/To:	Kryetarin e Komunës- Z.Smajl Latifi
CC:	Kuvendit të Komunës së Rahovecit
Përmes/Through:	Drejtëpërdrejt
Nga/From :	Z. Afrim Oruqi Drejtore i Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë
Subjekt/Subject:	Plani i punës për vitin 2025

Plani i punës për vitin 2025

Nga: Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë

Fillimi i vitit të ri, do të filloj me qasje në detyrat e reja dhe obligimet e mbetura nga viti paraprak.

Qysh në fillim të vitit 2025 do t'i qasem punës në realizimin e detyrave dhe përgjegjësi të përcaktuara nga Kryetari i Komunës në përputhje me Ligjin mbi vetëqeverisjen lokale dhe Statutin e Komunës së Rahovecit.

PRIORITETET e vitit 2025

Ri rregullimi i vektorit në të gjitha Zona Kadastrale në nivel Komune sipas kontrates për dixhitalizimin kadastral.

Prioritet kryesor gjatë vitit 2025 do të fokusohet në shërbime cilësore në përputhje me afatet kohore dhe të unifikuar ligjrisht.

Qëllimi kryesor i drejtorisë do të jetë i fokusuar në shërbime komfor akteve juridike.

Vazhdimi i evidentimit dhe lirim të pronave të uzurpuara në nivel të komunës.

Vazhdimi i inventarizimit të dokumentacionit dhe skenimi masiv i dokumentacionit të pa skanuar.

Shpronesimi i pronave private për hapje të rrugve publike- zgjerim të rrugve publike, për nevojat e komuniteteve etj. në nivel të Komunës.

SFIDAT e vitit 2025

Perfundimi i projektit dixhitalizimi kadastral për ri rregullimin i vektorit në të gjitha Zona Kadastrale në nivel Komune.

Themelimi i komisionit për komosacion bashkë me ministrit e linjes kompetente.

Dua të theksoj se në kuadër të Drejtorisë ekzistojnë dy sektorë:

Sektori për Kadastër dhe Pronë dhe

Sektori për Gjeodezi

Numri i punëtorëve në këtë drejtori është me sa vijon;

Gjithsej 10-të punëtorë, ku prej tyre, pesë janë me përgatitje të lartë shkollore (jurist-gjeodete, gjeograf), katër janë gjeodetë ku dy prej tyre janë me përgatitje të mesme, një referentë me përgatitje të lartë juridike dhe një vozitës.

Sektori për Kadastër dhe Pronë, gjatë periudhës një vjeqare parashihet që të pranojë dhe kryejë me shumë se 1400 lëndë.

Sektori për Gjeodezi parashihet që të pranojë dhe zgjidhë mbi 750 lëndë.

Vlen të përmendet sektori i gjeodezisë për punën e tyre që do të kenë në terren, si dhe shërbimi pronësor juridik për angazhimin e dhënë në përgatitjen e akteve si për nevojat e Kuvendit të Komunës ashtu edhe përgatitjen e akteve për persona fizikë dhe juridikë.

Do të vazhdojmë me përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm në lidhje me evidentimin e pronave si ato komunale dhe ato private që janë vendërrënjat e dëshmorëve të kombit me qëllim që këto parcela të shpallim zona me interes të veçantë, kjo mbetet sfida që të përfundohen deri në fund të vitit 2025.

Gjatë vitit 2025 nuk do të mungojë edhe qasja ndaj detyrave të tjera, si në sektorin e gjeodezisë ashtu edhe në atë të kadastrës dhe pronës, ku vlen të cekën:

- Propozim vendimet për seancat e Kuvendit Komunal

- Përgatitja e lëndëve për gjykatë dhe subjekteve të tjera të përfshira në zbatimin e ligjit.
- Shqyrtimi i kërkesave të ndryshme të qytetarëve dhe personave juridik.
- Punët e gjeodezisë inxhinierisë për nevojat e Kuvendit Komunal dhe palëve të tjera
- Matjet kadastrale për vërtetimin e uzurpimeve arbitrare,
- Përgatitja e Aktvendimeve për uzurpimet arbitrare,
- Punë të tjera sipas planit.

❖ **Me propozim të Kryetarit të Komunës, drejtuar Kuvendit të Komunës, do të bëhet shpallja e interesit të përgjithshëm të pronave komunale për zhvillim ekonomik të Komunës.**

❖ **Detyrat tjera të Drejtorisë**

- Përgatitja e akt dokumentit për angazhimin e gjeodeteve Komunal jashtë drejtorisë.
- Përgatitja e akteve ndaj uzurpatoreve në nivel të Komunës
- Dalja në terren e Shërbimit pronësor-juridik, me kërkesë të Drejtorisë për Inspeksion.
- Dalja e gjeodetëve në terren për matjen e rrugëve në nivel Komune.

Me respekt!



